

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

Fjalimit të Xhumasë

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masrur Ahmedit

mbajtur në Xhaminë Baitul Futuh të Londrës më

18 Qershor 2004

Kërkimi i diturisë

Hazuri e filloi fjalimin e tij me recitimin e ajetit 115 të sures Ta-Ha të Kuranit të shenjtë dhe vazhdoi duke thënë, se përkthimi i këtij ajeti është: **"Qoftë lartësuar Allahu, Sunduesi i vërtetë! Dhe mos u ngut me leximin e Kuranit para se të përfundojë shpallja e tij, dhe thuaj: "O Zoti im, shtomi dituritë!"** Këtu lutja që na është mësuar është **"O Zoti im, shtomi dituritë!"**. Duke na i mësuar këtë lutje në Kuranin e shenjtë, Allahu është treguar shumë i mëshirshëm ndaj nesh. Por, një gjë duhet të jetë e qartë se lutjet nuk pranohen vetëm me përsëritjen e fjalëve të thata. Kjo lutje, ua tërheq vëmendjen besimtarëve në faktin se ata gjithmonë duhet të jenë në kërkim të diturisë, duke e shoqëruar kërkimin e tyre me lutje; dhe pastaj Allahu do t'i hapë për ta horizontet e diturisë dhe të kuptuarit të vërtetë. Kjo nuk vlen vetëm për studentët, por për secilin prej nesh, madje edhe për ata që janë në moshë të shtyrë, edhe ata duhet t'i luten Allahut me këto fjalë dhe të vazhdojnë rrugën e tyre në kërkim të diturisë. Kjo është një lutje për të gjithë. Profeti i shenjtë^{sas}, na ka këshilluar që **ta kërkojmë diturinë prej djepit deri në varr**. Kjo, pra është rëndësia që Islami i kushton diturisë. Ju gjithashtu mund ta kuptoni rëndësinë e kësaj lutjeje nga fakti se Profeti i shenjtë^{sas}, e pasoi këtë këshillë gjatë gjithë jetës së tij. Allahu ishte Mësuesi i tij dhe i dha atij mësimin e shkëlqyer – Kuranin e Lartë, në të cilin të gjitha fshehtësitë se qiejve dhe tokës janë përfshirë; dhe krahas Muhamedit^{sas}, nuk ishte askush që mund ta kuptonte plotësisht. Në të ka profeci për gjëra që do të ndodhin në të ardhmen. Në të është edhe këshilla që të lutemi me fjalët: **"O Zoti im shtomi dituritë!"**. Pra, çdo besimtar duhet të përpiqet të fitojë dituri të reja, duke filluar me këtë lutje.

Ato sekrete që janë përmendur në Kuran para një mijë e pesëqind vjetësh, tani po zbulohen nga njerëzit. Të gjitha këto zbulime dalin në sipërfaqe për shkak të vullnetit dhe kërkimeve të njeriut dhe dëshirës së tij për t'i arritur ato. Sot, kjo përgjegjësi, më së shumti bie mbi supet e ahmedianëve. Ahmedianët duhet t'i bëjnë këto kërkime më shumë se çdokush tjetër, sepse Mesihut të Premtuar^{as}, iu shpalosën ato sekrete të fshehura të Kuranit të Shenjtë dhe pasuesit e tij e kanë marrë lajmin e mirë dhe premtimin e Allahut^{xhh}, se atyre do t'u dhurohen standarde të larta të diturisë. Për ta, përpjekjet në kërkim të diturisë, të shoqëruara me lutje, janë të domosdoshme.

Nëse lutjet tuaja nuk do ta pasohen me përpjekje, nuk do t'u jepet asgjë.

Për të fituar dijen e Kuranit të shenjtë dhe njohjen e religjionit në përgjithësi, ne duhet të kërkojmë ndihmë nga thesari (librat) i Mesihut të Premtuar^{as}, të cilin na e ka lënë pas. Ju duhet të shpalosni nëpër atë thesar sepse ai është i cili na e ka

treguar rrugën dhe mënyrën për të fituar dituritë e Kuranit të shenjtë. Është kjo dituri që gjendet në Kuranin e shenjtë e cila pastaj, do të ju shpie te dituritë e fushave të ndryshme. Ne duhet ta rrënjosim dëshirën dhe interesimin për të lexuar librat e Mesihut të Premtuar në të gjithë anëtarët tanë. Kam thënë vazhdimisht se jo vetëm të rinjtë por, edhe të vjetrit duhet ta kërkojnë diturinë dhe duhet t'i studiojnë veprat e Mesihut të Premtuar, e jo të ngelin prapa duke menduar se tani janë tepër të vjetër për të mësuar diçka të re.

Hazret Musleh Maud^{ra} (Allahu qoftë i kënaqur me të) (Kalifi i dytë i Mesihut të Premtuar^{as}) ka thënë se kur iu zbrit ky ajet Profetit të shenjtë^{sas}, dhe iu mësua kjo lutje, ai ishte në moshën 55-56 vjeçare. Nga kjo besimtarët duhet të kuptojnë se nxënia e diturisë është detyrim për besimtarët e të gjitha moshave. Njerëzit zakonisht mendojnë se moshja e re është për të fituar dituri, moshja e mesme është për të vepruar dhe moshja e vonë është moshë e urtësisë. Por, besimtari i vërtetë i ka të gjitha këto shkallë gjatë gjithë jetës së tij. Moshja e vjetër nuk e pengon atë për të fituar dituri, e as rinia nuk ia mjegullon urtësinë. Ai (ajo), gjatë gjithë jetës së tyre mbeten kureshtarë. Edhe në moshë të shtyrë, ata vazhdojnë me kërkimin e diturisë dhe kurrë nuk e konsiderojnë veten tepër të mplakur për nxënie. E keni shembullin e përkryer të Dërguarit të Allahut^{sas}, të cilin në moshën 56-57 vjeçare, Allahu e urdhëroi që të kërkonte dituri. Zakonisht njerëzit në moshë të shtyrë mendojnë se nuk kanë më nevojë për më tepër dituri, dhe e humbin dëshirën për të mësuar, por, Allahu i tha Profetit të Shenjtë^{sas}, të kërkonte edhe më shumë dituri. Kjo është rruga që secili besimtar duhet pasuar dhe kurrë nuk duhet të bëhet i pakujdesshëm në kërkimin e dijes në çfarëdo moshe qoftë ai. Disa njerëz në moshë, mendojnë se nëse shtroj ndonjë pyetje, njerëzit do të thonë: "*Shikoni moshën e tij, dhe ai ende shtron këso pyetjesh të thjeshta*". Në këtë mënyrë, ata privohen nga dituria. Ju nuk duhet ta keni këtë lloj ngurrimi.

Hazret Ibrahim^{as}, kishte arritur një moshë të shtyrë, kur e pyeti Allahun: "*O Allah! Më trego si i ringjallë Ti të vdekurit?*" Allahu nuk i tha atij: "*Tani ti je shumë i vjetër për këto gjëra dhe nuk duhet të shtrosh këso pyetjesh*". Pra, ju duhet gjithmonë të keni vullnet dhe etje për të fituar dituri dhe gjithmonë të luteni: "***O Allah! Shtomi dituritë***", sepse përderisa nuk e keni atë etje të pashuar, nuk do të përparoni. Disa mendojnë, se në moshë të shtyrë kujtesa e njeriut dobësohet dhe humbet. Në Rabvah unë e kam pasur një mësues, i cili edhe pas pensionimit, ende e dinte gjithë Kuranin përmendësh.

Hazret Ebu Hureira^{ra}, transmeton se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë^{sas} duke thënë: "***Është e domosdoshme për çdo mysliman të kërkojë dituri***". Nëse i shikojmë myslimanët e ditëve tona, e shohim se, krahasuar me popujt tjerë të botës kanë ngelur mbrapa me shkollim, ndërsa ne jemi këshilluar për nxënie të diturisë më shumë se të tjerët.

Në një transmetim tjetër H. Ebu Hureira rrëfen se Profeti i shenjtë ka thënë: "***Bamirësi e vërtetë është të kërkuarit e diturisë dhe shpërndarja e saj ndër të tjerët***". Kjo pra, është rëndësia e mbledhjes së diturisë dhe e shpërndarjes ndër të tjerë. Kjo është arsyeja pse na është thënë që të sillemi me respekt ndaj mësuesve tanë. Edhe nëse dikush jua ka mësuar një fjalë të vetme, kujtoni atë njeri si mësues tuajin dhe respektoni. Ata e kanë një status të lartë.

Në ditët tona profesion i mësuesit është duke u trajtuar me pa respekt dhe është duke u konsideruar vetëm si një punë sa për të sjellë një rrogë në shtëpi. Natyrisht se njeriu duhet ta fitojë bukën e gojës me diçka, por, në Pakistan, mësuesit nëpër shkolla nuk përqendrohen në mësimdhënie dhe u thonë

nxënësve që të shkojnë pas mësimit nëpër shtëpitë e këtyre "mësuesve" për të mësuar me pagesë. Nëse dikush mund të paguajë, ndoshta është në rregull, por problemi kryesor është që këta "mësues" nuk i lënë rehat as të varfrit duke u thënë se nëse dëshironi të kaloni duhet të vini te unë pas orarit. Prindërit e disa nxënësve pastaj detyrohen të marrin para hua për të paguar mësuesit e fëmijëve të tyre; dhe kjo shkakton shumë vështirësi. Mësuesit ahmedian duhet të përmbahen nga praktika të tilla. Diturinë që e kanë fituar duhet ta shpërndajnë dorëllirshëm ;dhe Allahu do t'i shpërbleja për këtë. Allahu i ka thënë Profetit të Tij^{sas}: **"O mesazhbartës! Thuaju njerëzve se unë nuk kërkoj ndonjë shpërblim prej jush për gjërat që ua mësoj".**

Transmetohet nga Hazret Maslub^{rah} i cili tregon se shkoi një herë te Hazret Abdullah bin Masud^{rah}, dhe e dëgjoi duke thënë: "O njerëz! Nëse dini diçka me vlerë, tregojuni të tjerëve. Nëse pyeteni për diçka që nuk e dini, duhet vetëm të thoni Allahu A'lamu – Allahu e di më së miri".

Ky është gjithashtu një mësim i mirë për të gjithë, e sidomos për mësime dhënësit të cilët shkojnë të papërgatitur në mësim dhe vetëm flasin çka tu vije në gojë. Sipas hadithit që sapo e përmendëm, mësime dhënësi që ka shkuar në shkollë i papërgatitur, duhet t'u thotë nxënësve se nuk ka qenë në gjendje të përgatis mësimin për sot dhe nuk do të thotë asgjë.

Në një hadith tjetër, H. Ebu Hureira^{ra} transmeton se e ka dëgjuar Profetin e shenjtë duke thënë: "Kërkoni diturinë dhe respektoni ata që u kanë mësuar". Në këtë ka një mësim për nxënësit dhe studentët të cilët porositen që t'i nderojnë mësime dhënësit e tyre. Në vende të ndryshme, në ditët tona, studentët dalin nëpër rrugë në protesta të dhunshme dhe thyejnë dritat e rrugës, dëmtojnë pronën e shtetit dhe atë të njerëzve, ua japin flakën dyqaneve, etj. Kjo është një mënyrë krejtësisht e gabuar dhe e ulët. Ky nuk është mësimi i Islamit. Studenti duhet të jetë në kërkim të diturisë dhe duhet të sillet me dinjitet dhe t'i respektojë dhe nderojë me zemër mësime dhënësit e tyre, e jo të sillen në mënyrë të paedukuar. Pastaj shumë nga Mësuesit ahmedian ballafaqohen me situata ku studentët joahmedian, kur bien në provime për shkak se nuk janë përgatitur, ata menjëherë organizohen në protesta dhe si rezultat disa mësime dhënësit ahmedian ballafaqohen me vështirësi të shumta. Studentët ahmedian duhet të mos marrin pjesë në protesta dhe demonstrata të këtilla nëpër shkolla dhe universitete. Ata duhet ta mbajnë dinjitetin e tyre prej studenti.

Hazret Abdullah bin Amr^{ra}, transmeton se: "Një ditë Profeti i shenjtë doli nga shtëpia e tij dhe u fut në xhami. Në xhami i pa njerëzit të mbledhur në dy grupe. Në një grup, njerëzit po lexonin nga Kurani i Shenjtë, ndërsa në grupin tjetër dikush po i mësonte të tjerët. Profeti tha se: "Të dy grupet po bëjnë punë të devotshme, njëri grup po reciton Kuran dhe po lutet; dhe Allahu do të vendosë se a do t'u japë apo jo, atë që po kërkojnë. Por, unë do të ulem me grupin që po mëson, sepse Allahu më ka dërguar si mësues. Dhe shkoi e u ul me ata që po mësonin". Ky pra është statusi që Profeti i Shenjtë ua ka dhënë atyre që mësojnë dhe që japin mësim.

Në një hadith tjetër ai ka thënë:

Hazret Abdullah bin Abas transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: **"Kur të kaloni nëpër kopshtet e Xhenetit, kullotni mirë"**. Dikush pyeti se për çfarë kopshtesh të Xhenetit ishte fjala? Ai tha: **"Këto janë tubimet e diturisë. Pra, kur të shkoni nëpër këto tubime, mundohuni të mbliidhni sa më shumë dituri që mundeni"**. Pra, në mënyrë metaforike, Profeti ka thënë "kullotni mirë". Kur të vini nëpër tubimet e Xhematit, duhet të

vini me qëllim që të fitoni dituri. Nëse kur të ktheheni nga këto tubime, vazhdoni me avazin e vjetër dhe bëni gjëra që janë në kundërshtim me atë që është thënë në këto tubime, atëherë çfarë kuptimi ka ardhja juaj në këto tubime.

Hazuri tha, po e përsëris, se librat e Mesihut të Premtuar janë burim i diturisë, dhe ju duhet t'u ktheheni me seriozitet atyre. Ato janë komentim i Kuranit të Shenjtë. Mesihu i Premtuar, ka thënë: "Qëndrimi me mua do t'u bëjë juve të arrini urtësinë e vërtetë. U them njerëzve të vinë dhe të rrinë me mua. Çdo frymë që e merrni, është një frymë më afër vdekjes. Nuk i ka hije besimtarit t'i mbyllë veshët e tij nga këshilla e Allahut. Ju nuk duhet të jeni nga ata që nuk e çmojnë këtë thesar të hapur. Ata që e kanë kuptuar se çka ka sjell Allahu për të mirën tuaj, ata do të jenë ata që do ta çmojnë dhe nderojnë atë. Ata që janë të pakujdesshëm do ta dëmtojnë vetën e tyre. Pas fitimit të diturisë, ju duhet të filloni të veproni, por veprimet nuk mund të merren, pa e fituar atë dituri përmes qëndrimit me të devotshmit. Mesihu i Premtuar thotë se ju duhet të vini dhe të qëndroni me mua për të fituar atë dije dhe urtësi. Mesihu i Premtuar thotë se disa thonë se më kanë shkruar dhe nuk kemi marrë përgjigje të kënaqshme. Problemi është që ata nuk vijnë të na vizitojnë, dhe kjo është arsyeja e pakënaqësisë së tyre. Ka libra të shkruara nga Mesihu i Premtuar, gjithashtu fjalimet dhe bisedat e Mesihut të Premtuar janë botuar. Ju duhet t'i lexoni dhe t'i studioni ato dhe kjo do të ishte zëvendësim i shoqërimit me Mesihun e Premtuar. Përveç përfitimeve të tjera shpirtërore, ju gjithashtu do të jeni në gjendje t'u përgjigjeni kënaqshëm kritikëve antiahmedian, dhe gjithashtu dituritë tuaja do të shtohen.

Pastaj Mesihu i Premtuar^{as} ka thënë se nuk kishte as që mund të ketë njeri më të përkryer dhe më të ditur se Profeti i Shenjtë, por edhe atij Allahu i tha që të kërkonte për më shumë dituri. Pra, kush mund të jetë më i përkryer e të mund të mendojë se unë tani e kam arritur zenitin e diturisë. Në fakt, ai i cili përparon në dituri, ai vetëm e kupton se shumë ka mbetur për t'u mësuar. Ka disa faktorë që në fillim duken se janë jologjike, por, pastaj duke mësuar më tepër kuptohen se ato janë elemente të vërteta dhe janë të vërteta qenësore. Është e domosdoshme të mblidhni dituri. Ju i keni braktisur shumë besime jologjike dhe e keni lidhur veten tuaj me këtë komunitet, por nëse nuk i shtoni edhe më dituritë tuaja, atëherë cili është qëllimi i futjes në këtë Xhematë. Nëse keni dyshime dhe hezitime, ato gradualisht do ta bëjnë njeriun që të ngecë.

Ka dy grupe njerëzish: njëri është që pasi ta pranon Islamin, okupohet me punët dhe bizneset e botës dhe të cilët djalli i fut nën kontroll. Nuk ju them se është gabim të merreni me tregti dhe biznese; sahabët janë marrë me tregti gjithashtu, por ata gjithmonë i jepnin prioritet fesë dhe besimit. Hazret Xhabir bin Abdullahu^{ra}, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: **"Mos u mundoni të fitoni dituri me qëllim që të tregoheni të ditur para të njerëzve dhe të fitoni famë përmes asaj diturie. Ai i cili punon në atë mënyrë, për të nuk do të ketë asgjë tjetër përveç zjarrit".**

Në ditët tona, të ashtuquajturit dijetarë të Islamit sillen në këtë mënyrë dhe vetëm dëshirojnë të paraqiten si dijetarë të mëdhenj dhe kjo nuk i sjell asnjë dobi askujt. E vetmja gjë që ata synojnë është të tregojnë se unë di dhe ju nuk dini. Ahmedianët duhet ta mbajnë në mend se kërkimi i diturisë, nuk duhet të jetë për hir të unit të tyre dhe për t'u shfaqur diturinë e tyre para njerëzve, por qëllimi i tyre duhet të jetë që diturinë e fituar ta shpërndajnë ndër të tjerë për kënaqësinë e Allahut^{xhh}. Ju e dini atë ndodhi nga jeta e Mesihut të Premtuar^{as}, kur refuzoi të hynte në debat me njërin nga opozitarët e tij. Përkrahësit e Mesihut të Premtuar^{as} u hidhëruan shumë; por ai vetëm tha se pasi nuk po shoh

ndonjë diferencë në besimet tona, nuk kemi përse të debatojmë. Allahu^{xhh} e shprehi pëlqimin dhe kënaqësinë e Tij përmes revelatës që ia shpalli atë ditë Mesihut të Premtuar^{as}. Pra qëllimi i vetëm që ju duhet ta keni gjatë kërkimit të diturisë është që të përfitoni nga ajo dituri dhe t'i shërbeni njerëzimit me të.

Në një hadith tjetër, Hazret Ebu Darda^{ra}, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: **"Ai njeri i cili del në kërkim të diturisë, Allahu e bën të lehtë udhëtimin e tij për në Parajsë. Engjëjt janë aq të kënaqur me atë person sa që e mbulojnë me krahët e tyre. Çdo gjë e gjallë lutet për të, madje edhe peshqit në oqean luten për atë njeri. Ata njerëz që janë në kërkim të diturisë janë si yjet në qiell".**

Ata që vijnë në vendet e Perëndimit në kërkim të diturisë, nëse do të vijnë me qëllim për ta kënaqur Allahun me diturinë e tyre, atëherë Allahu do ta bëjë të fituarit e diturisë të lehtë për ta, dhe Ai gjithashtu do ta bëjë të lehtë rrugën për në Parajsë. Allahu për këta njerëz e bën të lehtë edhe jetën e kësaj bote. Studentët ahmedianë që vijnë në Perëndim në kërkim të diturisë, duhet të vijnë me të vetmin qëllim për të fituar dituri dhe të ecin rrugës së përshkruar nga Allahu i Madhërishëm. Nuk duhet të mashtrohen e të shkojnë pas atyre gjërave që të tjerët zakonisht shkojnë. Nëse hasin në ndonjë mësim që është në kundërshtim me mësimet e Allahut, ata duhet t'u tregojnë të tjerëve të vërtetën.

Hazret Zejid Bin Sabit transmeton se Profeti i Shenjtë^{sas}, më dha për detyrë që të mësoja gjuhën siriane dhe më tha: **"Mësoje gjuhën e çifutëve, sepse nuk e di se çka më shkruajnë kur më dërgojnë letra".** Hazret Zejid thotë më tutje se: **"Brenda pesëmbëdhjetë ditësh mësova të shkruaj e të lexoj dhe kur vinte ndonjë letër, ia lexoja të Dërguarit të Allahut".**

Këtu dëshiroj t'u drejtohem fëmijëve të dedikuar "Vakfe Nau"¹. Ata fëmijë 'Vakfe Nao' që e kanë arritur moshën e të kuptuarit dhe që kanë prirje dhe talent për mësimin e gjuhëve të huaja, dua t'i këshilloj që të mësojnë anglisht, urdu dhe arabisht, krahas gjuhës së vendit ku jetojnë. Ata duhet t'i mësojnë këto gjuhë në një nivel shumë të lartë dhe pastaj ta përkthejnë literaturën e Xhematit në gjuhë të ndryshme të botës. Vetëm atëherë ne mund të kemi ndikim në ato vende. E kam vërejtur se vajzat kanë më shumë talent për mësimin e gjuhëve. Gjatë qëndrimit tim në Gana, në pjesën e qytetit ku banoja, kishte një kishë katolike, prifti i të cilës ishte nga Anglia. Ai me një motoçikletë, shkante dhe qëndronte disa ditë me radhë në disa fshatra të largëta. E pyeta se ç'bënte atje. Ai më tha se ishte një fis që numëronte jo më shumë se dhjetë-pesëmbëdhjetë mijë njerëz që flisnin një gjuhë të veçantë dhe unë po shkoj atje për të mësuar gjuhën e tyre në mënyrë që të mund të përkthejë Biblën në gjuhën e tyre. Pra, anëtarët tanë, e posaçërisht fëmijët *vakfine nau*, duhet të fokusohen në këtë fushë, sepse ka shumë nevojë për ekspertë të gjuhës. Shumë fëmijë tani kanë arritur moshën për universitet, ata gjithashtu duhet t'i kushtojnë vëmendje kësaj. Në vendet përkatëse, departamentet e fëmijëve të dedikuar (vakfine nau) duhet t'i përgatisin listat e këtyre fëmijëve, dhe pastaj për çdo vit këto lista duhet të rishikohen dhe plotësohen me emra të rinj që do ta arrijnë atë moshë. Xhemati nuk ka nevojë vetëm për ekspertë në fushën e gjuhëve, por edhe janë predikues, mësues, mjekë, ekspertë të informatikës, avokatë, inxhinierë, etj. Gjatë vizitave të mia në Xhemate të ndryshme, kam biseduar me fëmijët e moshës gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetë vjeçare, të cilët ende nuk kanë

¹ Fëmijët që prindërit e tyre i kanë dedikuar në shërbim të Xhematit para lindjes së tyre. Kur këta fëmijë arrijnë moshën e vetëdijes së plotë, do të pyeten nga Xhemati se a dëshirojnë ta dedikojnë jetën e tyre në shërbim të Xhematit apo jo. Nëse ata pranojnë, atëherë ata do të shkollohen në profesione të ndryshme dhe pas përfundimit të shkollimit, do të punojnë në shërbim të Xhematit. Ky program është filluar nga Kalifi i IV^{ie} i Mesihu të Premtuar, Hazret Mirza Tahir Ahmad në vitin 1987.

vendosur se cilin drejtim do ta marrin. Ata nganjëherë përmendin ndonjë fushë, për të cilën Xhemati tani për tani nuk ka nevojë. Për shembull, disa thonë se dëshirojnë të bëhen pilotë. Disa thonë se kanë interesim në sport dhe dëshirojnë të bëhen futbollistë, etj. Këto nuk janë profesione për të dedikuarit (vakfe nau). Unë e ndjej se ata nuk janë drejtuar mirë nga të rriturit, dhe tani nuk dinë çfarë drejtimi të marrin. Prindërit nuk duhet vetëm t'i dedikojnë fëmijët e tyre në shërbim të fesë, por, duhet gjithashtu të punojnë me ta, t'u shpjegojnë atyre qëllimin e vërtetë të dedikimit.

Gjithashtu kam takuar fëmijë të cilët me gjithë moshën e tyre l, nuk e dinë çka do të thotë *vakfe nau*. Prindërit e tyre thonë se ky fëmijë është vakfe nau, (i dedikuar) ndërsa fëmija nuk e di. Disa të tjerë thonë se prindërit tanë na kanë dedikuar, por ne dëshirojmë të bëjmë diçka tjetër në jetë. Pra, kur të përgatiten këto lista, atëherë ne do të mësojmë se sa prej tyre do ta lëshojnë programin me të arritur moshën e pjekurisë dhe sa do të vazhdojnë. Listat pastaj do të tregojnë për secilin vend se sa kanë vendosur të studiojnë për predikues, doktorë, inxhinierë, mësues, etj. Para dhe gjatë kësaj procedure, xhematët lokale duhet të marrin instruksione nga Qendra. Nganjëherë dikush që dëshiron të bëhet doktor dhe ka interesim në tri-katër fusha të mjekësisë, Xhemati duhet ta orientojë atë në atë degë për të cilën Xhemati ka më së shumti nevojë.

Listat e përgatitura duhet pastaj për çdo vit të rishikohen e të plotësohen me të dhënat e reja. Atyre listave për çdo vit u shtohen emrat e atyre që arrijnë moshën e pjekurisë dhe që dëshirojnë të vazhdojnë si vakfe nau, ndërsa ata që dëshirojnë të largohen, t'u shlyhen emrat nga listat. Për ata që janë duke studiuar, për ta duhet të kujdeseni se çfarë pune do të fillojnë pas studimeve të tyre. Në gjithë botën kjo detyrë duhet të kryhet dhe këto lista duhet të përgatiten brenda tre-katër muajve të ardhshëm. Këto lista duhet të përgatiten për fëmijët që janë mbi pesëmbëdhjetë vjeç. Profesione të përmenda më lartë, nuk janë të vetmet për të cilat Xhemati ka nevojë. Ka disa fëmijë që janë shumë të talentuar, për shkenca të ndryshme natyrore ose shoqërore, ose në fusha të tjera. Ata fëmijë duhet t'i orientojmë në ato drejtime për të cilat kanë talent dhe interesim. Pra, në secilin vend, duhet të ketë departamente të posaçme për këta fëmijë. Ne duhet t'i udhëzojmë ata me kujdes. Ka disa të cilët e dinë mirë se cilën fushë të studimeve e pëlqejnë, por një numër i madh duhet të udhëzohet dhe kjo duhet të bëhet me kujdes të posaçëm.

Pasuesit e Mesihut të Premtuar^{as}, janë përgëzuar me lajmin e mirë se ata do t'ua kalojnë të tjerëve me dituri. Mesihu i Premtuar thotë: **"Janë gabim ata hoxhallarë që janë kundër mësimit të shkencave bashkëkohore. Është pjekur në kokën e tyre se shkencat bashkëkohore i largojnë njerëzit nga Zoti. Kjo nuk është e vërtetë. Ata nuk kanë kapacitet t'i kuptojnë këto gjëra; ata nuk mund ta kuptojnë filozofinë e këtyre shkencave; dhe vetëm i mbyllin sytë dhe thonë se këto janë gabim".**

Pra, ne duhet t'ua mësojmë këtyre fëmijëve të dedikuar shkencat moderne mirë e mirë. Mesihu i Premtuar ka thënë se urtësia dhe dituria më e madhe është në Kuranin e Shenjtë. Allahu na mundësoftë që të kemi një armatë të tërë të këtyre të dedikuarve, të pajisur me dije të mirëfillta.

Për të arritur rezultate të kënaqshme me këta fëmijë, dhe me të gjithë fëmijët e tjerë të Xhematit, është e domosdoshme që gratë tona të punojnë më shumë në zgjerimin e diturive të tyre dhe t'u kushtojnë më shumë kohë këtyre fëmijëve. Kjo është një kërkesë e madhe e kohës. Unë kërkoj me ngulm nga gratë e

Xhematit që t'i kushtojnë më shumë kujdes trajnimit të fëmijëve të tyre. Zakonisht, aty ku nënat janë të dijshme dhe punojnë me fëmijët e tyre, ata fëmijë janë të dalluar nga të tjerët. Pra, nënat duhet t'i zgjerojnë horizontet e diturive të tyre dhe pastaj t'i bartin ato tek fëmijët e tyre.

Kjo nuk do të thotë se baballarët nuk paskan asnjë obligim ndaj fëmijëve të tyre. Është detyrë e burrave dhe baballarëve që së pari të japin shembullin e tyre personal. Ata nuk mund t'i mësojnë fëmijët e tyre nëse vetë nuk janë të dijshëm dhe në kërkim të diturisë. Nëse burrat nuk krijojnë atmosferë mirëqenieje në shtëpi dhe nuk ecin rrugës së devotshmërisë, kjo do të ndikojë në gratë dhe fëmijët e tyre. Nëse burrat insistojnë, ata mund të zgjojnë interesim në gratë e tyre për të mësuar, dhe kjo automatikisht do të ndikojë edhe te fëmijët e tyre.

Anëtarët e Xhematit, burra e gra, duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme kërkimit të diturisë. Nëse burrat tregojnë interesim në zgjerimin e diturive të tyre, atëherë edhe gratë e tyre fillojnë të interesohen. Kjo automatikisht reflektohet te fëmijët e tyre, dhe ata fillojnë ta kuptojnë se ne dallojmë nga njerëzit e tjerë të botës; dhe se ne kemi qëllime të larta në jetë. Përndryshe si mund të ndikojmë tek të tjerët përreth nesh dhe t'i udhëzojmë, nëse nuk e kemi reformuar vetën tonë. Pra, burra dhe gra, së bashku duhet të mundohen, që të mund ta shpëtojmë gjeneratën e ardhshme. Na dhëntë Allahu^{xhh} mundësi të fitojmë dituri, të përfitojmë vetë prej saj dhe ta bartim atë në gjeneratat e ardhshme. Amin!

<p>Note: 18 June 2004</p>	<p>This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of: The topic of this Khutba is: 'The Quest after Knowledge' This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam'aat</p>
--------------------------------------	---